
RAPORT TEKNIK

(Sipas Vendimit Nr. 686 datë.29.07.2015)

“Pike grumbullimi skrapi dhe demontim makinash”

Subjeti zhvillues: "AUTO-FAMILJA" SHPK

Hartoi Raportin Paraprak të VNM-së :

Per “TAULANT” Sh.p.k

Ing.Erjona Qatipi

TIRANE 2021

RAPORT TEKNIK

Subjekti: "AUTO-FAMILJA" SHPK

Hartoi Raportin Paraparak te VNM-se: "TAULANT" SHPK

PËRMBAJTJA

<i>Hyrje</i>	4
1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	5
a) <i>Qellimi i projektit te propozuar;</i>	5
b) <i>Planimetria e vendodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me kordinatat sipas sistemit Gaus Kruge, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise;</i>	5
c) <i>Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e propozuar, si edhe percaktimin e njesise Vendore qe administron territorin ku propozohet projekti;</i>	8
ç) <i>Skicat dhe planimetrite e objekteve dhe strukturave te projektit si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit</i>	9
d) <i>Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit;</i>	9
dh) <i>Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja;</i>	12
e) <i>Programin per ndertimin, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te prjektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit;</i>	13
ë) <i>Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji);</i>	13

TAULANT SHPK

- f) Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/ prane zones se projektit; _____14
- g) Informacion per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret; _____14
- gj) Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre; _____14
- h) Te Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj; _____15
- i) Informacion per lejet, autorizimet dhe licensat e nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licensimin e projektit; _____15
- j) Kopje te lejeve, autorizimeve dhe licensave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar; _____15

❖ HYRJE

Zhvilluesi i aktivitetit "Pike grumbullimi skrapit dhe demontim makinash "AUTO-FAMILJA" i cili zhvillohet ne nje siperfaqe totale 10888 m². Adresa: Rruga Nacionale Berat-Morave, godine nje kateshe me nr. pasurie 286/60, zone kadastrale 3978.

Per kete do te pergatitet nje raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis te ketij projekti per pajisjen me pas me leje mjedisi Tipi B.

Projekti do te zhvillohet ne nje parcele relativisht te sheshte, pronesia e te ciles eshte ne pronesi te administratorit te sybjektit "AUTO-FAMILJA".

Aktiviteti sipas Ligjit Nr. 10 440, date, 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", projekti ne fjale **klasifikohet ne Shtojcen II, pika 11. Projekte te tjera. d) Depot e skrapit te hekurit, perfshire ato nga automjetet.**

Te dhena teknike:

Siperfaqe totale e vendit ku ushtrohet aktiviteti eshte 10888 m²

Kapaciteti i demontimit eshte 3 makina/dite

Kapaciteti i magazinimit te hekurishteve eshte 5 ton/dite

➤ **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

a) **Qëllimi i projektit të propozuar**

Qëllimi i këtij aktiviteti është magazinimi i hekurishteve dhe grumbullimi i automjeteve të përdorura në fund të jetës. Automjetet e përdorura do të jenë në funksion të aktivitetit pasi ato kur mbërrin në subjekt vijne me mungesë të gomave dhe baterive të cilat shiten paraprakisht nga pronari i mjetit. Të gjitha proceset e punës që nga grumbullimi i skrapit dhe i automjeteve të përdorura, transportimi i tyre në vendgrumbullimin e caktuar, montimin e tyre, do të zbatohen konform akteve ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

b) **Planimetria e vendodhjes së projektit, ku pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit Gaus Krüge, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkoheisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.**

Aktiviteti merr në konsideratë masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi i tyre të kryhet pa dëmtoar shëndetin e njeriut dhe pa i sjellë dëm mjedisit, vecanërisht:

- Pa krijuar rreziqe për ujë, ajër, tokë, florë dhe faunë
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa dëmtoar peisazhin

Një synim tjetër është të përcaktojë dhe rekomandojë masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Në këtë aktivitet të subjektit janë punësuar disa punonjës për kryerjen e punës dhe funksionimit të saj në vazhdimësi. Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloji mbetjeje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë problem mjedisor të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës së bashku me zhvillim të madh që është bërë në industri të ndryshme në mënyrë të ngjashme me të njëjtën shpejtësi është rritur edhe sasia e mbetjeve nga përdorimi i të mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane të patrajtuara, emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi i kimikateve të reja pa marrë parasysh dëmet që mund të sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballlemi ditët e sotme.



Vendodhja e aktivitetit

Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS GRUGER


Nr.	E	N
1	4406290.79	4516218.05
2	4406275.61	4516237.82
3	4406555.57	4516598
4	4406572.21	4516583.81

Tabela Nr.2. Kordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH

Nr.	E	N
1	490582.62	4515498.79
2	490567.24	4515518.39
3	490843.04	4515881.69
4	490859.84	4515867.69

Te dhenat teknike e aktivitetit		
1	Siperfaqja totale e vendit ku ushtrohet aktiviteti	10888m ²
2	Kapaciteti i demontimit	3makina/dite
3	Kapaciteti i magazinimit te hekurishteve	5 ton/dite

Projekti ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit pike grumbullimi skrapi dhe demontim makinash ne adrese: Rruga Nacionale Berat-Morave, godine nje kateshe me nr. pasurie 286/60, zone kadastrale 3978.



Harta topografike e zones

- c) Informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

Vendi ku do të ushtrohet aktiviteti për pike drumbullimi skrapit dhe demontim makinash është në Rrugën Nacionale Berat-Moravë, godinë nje kateshe me nr. pasurie 286/60, zone kadastrale 3978. Subjekti "AUTO-FAMILJA" ka ushtruar edhe me pare aktivitetin ne kete vendodhje duke gene se do te shtoj kapacitetin e magazinimit te hekurishteve dhe aktivitetin e demontimit te makinave ne fund te jetes po ndjek procedurat e nevojshme per tu paisur me Vendim Mjedisor e me pas per leje Mjedisi Tipi B sipas ligjit ne fuqi.

Vendi ku do të ushtrohet aktiviteti ndodhet buze rruge dhe i distancuar nga zonat e banuara kjo tregohet dhe në figuren e mëposhteme.



Distanca me zonat e banuara

Sic duket edhe nga Figura e mesiperme vendi ku do të ushtrohet aktiviteti ndodhet i distancuar nga zonat e banuara.

TAULANT SHPK

c) Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

"AUTO-FAMILJA" ushtron aktivitetin pike grumbullimi skrapit dhe demontim makinash ne rrugen Nacionale Berat-Morave, godine nje kateshe me nr. pasurie 286/60, zone kadastrale 3978. Dhe nuk do te bej ndertim te ri pasi ne kete siperfaqe ku do te ushtrohet akiviteti ndodhet e ngritur nje godinen e cila eshte dhe me document pronesia me nje siperfaqe prej 486.6 m². Para ketij fakti skemi as skica dhe as planimetri per ndertim.

d) Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

Proceset teknologjike ne kete projekt, jane ato te magazinimit te hekurishteve/skrapeve te hekurit kapaciteti i te cileshe eshte 5 ton/dite, dhe demontimi i makinave ne fund te jetes kapaciteti per te cilat eshte 3 makin/dite.

Pershkrimi teknologjik i aktivitetit

Aktiviteti si veprimtari kryesore ka magazinimin e hekurishteve/skrapeve te metalit dhe cmontim,demontimin e pjesëve të ndryshme të makinave, ky aktivitet konsiston ne magazinimin e hekurishteve/skrapeve te metalit ne fund te jetes dhe tregetimin e tyre.

Pajisjet jane bashkekohore dhe te lehta ne perdorim dhe manovrim, nuk ka clirime të gazrave apo shkarkime të tjera të dëmshme të rrezikshme e me natyrë ndotjeje.

Do te merren keto mbetje dhe do te cmontohen sipas llojeve te skrapit dhe me pas do ju jepen subjekteve te licensuara qe kane nevojte per keto lende.

Per te realizuar punimet dhe veprimet e mesiperme nevojiten:

- Ndarja e pjeseve te skrapit.
- Per ndarjen mund te nevojiten vegla pune mekanike etj.

Kapaciteti i proketuar i magazinimit te hekurishteve/skrapeve te metalit eshte:

- Demontim i 3 makinave ne dite
- Magazinim i 5 tone makina ne dite

Subjekti ka per qellim magazinimin, rekuperimin hekurishteve/skrapeve te metalit ose çmontim

TAULANT SHPK

te mbetjeve nga motoret e makinave dhe keto jane disa nga fazat e kalimit ne subjekt;

Faza 1 Depozitimi i skrapeve te metalit

Ne momentin qe lenda e pare vjen ne subjekt ajo depozitohet ne sheshin e percaktuar paraprakisht, ku me pas do te behet ndarja dhe seleksionimi sipas llojit te skrapeve qe mund te jene mbetje te pastra te perbera vetem me nje lidhje celiku, hekur ,plumb qe mund te jene me nje ose me shum lidhje, tornitura, skorje etj.

Faza 2 Seleksionimi dhe ndarja

Pas depozitimit se skrapeve te ndryshme te metalit ne subject behet demontimin manual i pjesëve të ndryshme të makinave, pajisjeve jashtë perdorimi, seleksionimi i tyre dhe ndarja sipas llojit, per kete proces nevojiten vegla pune mekanike.

Faza 3 Magazinimi

Subjekti eshte i ndare me kapanone ku behet magazinimi sipas llojit te skrapit i pjeseve te motorrike te automjeteve, kryesisht pjeseve elektromekanike dhe skrapeve te ardhura ne subjekt nga kliente te ndryshem.

Ne baze te ketyre fazave subjekti kryen keto sherbime;

- Ndarja e pjeseve te skrapit ne pjese te vecanta
- Demontimi i produkteve të gomës dhe qelqit.
- Pastrimi i brendshëm: Karriget, elektronika, produktet plastike hiqen.
- Demontimi i pajisjeve elektrike.
- Shtypja dhe riciklimi i mëtejshëm i pjesëve metalike.

Linja e seleksionimit e cila perbehet nga hinka, transportieri, dhe boksi ku mblidhet materiali perfundimtar i seleksionuar.

- Presa (e cila realizon presimin e mbetjeve).
- Thversi i cili ben coptimin e mbetjeve.
- Preresi ne forme pince i cila ben te mundur prerjen e profileve te gjata te mbetjeve.

Te gjitha trajtimet mekanike te lart permendura (prerjet, ashklat, grisjet ose granulimet, ndarjet, ndarje ne lloje, pastrimi, heqja e ndotjes, boshatisja) qe nevojiten per te pergaditur metalin skrap per input te drejtperdrejte ne perdorim perfundimtar ne punimet dhe fonderite e celikut duhet te jee te plotsuara.

Ka edhe pajisje dhe mjete te tjera qe kompletojne dhe jane te domosdshme per te kryer funksionin e perpunimit ne linjen teknologjike sipas procesit teknologjik te percaktuar. Ketu

TAULANT SHPK

perفشihen makinerite qe kryejne transportime te lendes se pare, ndihmese dhe produktit te gatshem, (si pirunat), oficina mekanike per riparimin dhe mirembajtjen e linje teknologjike, kabina elektrike, dhe magazinat.

Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lendeve te para

Ky aktivitet nuk parashikon perdorimin e lendeve te para, pervec automjeteve dhe pjeseve te tyre qe hyjne ketu. Kjo do te thote qe jo vetem skemi perdorim te burimeve natyrore, por perkundrazi kemi rikuperim dhe vlersim te burimeve te cilat jane perdorur me pare, sic jane autoveturat, duke limituar ne maksimum asgjesimin perfundimtar dhe humbjen e ketyre materialeve.

Mbetjet e prodhuara nga aktiviteti

Aktiviteti i grumbullimit te skrapit dhe demontimit te automjeve te perdorura, me shume se prodhim mbetjesh, parashikon asgjesimin dhe mbi te gjitha rikuperimin e ketyre mbetjeve. Ne specifike ky aktivitet konsiston ne grumbullimin e materialeve te perdorura, te cilat nepermjet procesit te cmontimit parashikojne rikuperimin e te gjithe materialeve dhe ne raste te tjera tregtimin dhe shitjen e pjesve te kembimit te perdorura. Mbetjet e ngurta te krijuara gjate aktivitetit te punes nga personeli grumbullohen ne vende te posacme prane subjektit dhe largohen ne menyre periodike per ne vendet e percaktuara per to nga Pushteti Vendor. Kurse persa i perket mbetjeve vajore qe dalin nga procesi i demontimit te automjeteve per kete subjekti ka lidhur kontrate me subjekte te licensuara.(konkretisht me subjektin Amos Oil sh.a)

Masat kunder zjarrit

Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne rast zjarri, subjekti do te marre masa te menjehershme dhe pse kemi te bejme me nje aktivitet qe zhvillohet ne ambjente te hapura. Subjekti po investon per projektin e mbrojtjes nga zjarri.

Aktiviteti ne fjale nuk ka proces prodhimi ai ben vetem gumbullimin e skrapeve te hekurit dhe demontimin e mjeteve ne fund te jetes. Pra ne kete aktivitet nuk ka nje produkt perfundimtar.

dh) Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

Furnizimit me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti ekzistues i zones, për të cilin subjekti disponon kontrate të rregullt me OSHEE komform rregullave e ligjeve në fuqi. Furnizimi ekzistues me energji elektrike i këtij territori është ai i Bashkisë Berat. Gjithashtu në subjekt ndodhet një gjenerator rezerve me fuqi 5 kw. Ky gjenerator punon me lëndë djegëse benzine dhe përdoret në raste të rralla në momentin që ka ndërprerje të energjisë elektrike.

Furnizimit me ujë

Në këto aktivitete nuk përdoret ujë në proceset e punës ujë do të përdoret vetëm për nyjet higjieno-sanitare. Furnizimi me ujë bëhet nëpërmjet Ujesjellesit Berat. Subjekti ka ndërtuar një gropë septike për grumbullimin e ujërave sanitare në të cilën shkarkohen edhe një pjesë e ujërave që vijnë nga reshjet dhe mund të prekin pjesën e magazinimit të skrapit. Për sa i përket ujërave të largjes së shesheve të punës dhe ujërat që vijnë nga reshjet e shiut, nëpërmjet kanalizimeve të brendshme të subjektit shkarkohen një pjesë në gropë septike dhe pjesa tjetër shkarkon në kanalizimet e zones.

Shkarkimet e ujërave të ndotura

Sic e kemi përmendur edhe më sipër ky lloj aktiviteti nuk përdor ujë gjatë procesit të operimit edhe si pasojë nuk do të këto shkarkime të ujërave. Ujë do të përdoret vetëm për nyjet higjieno-sanitare shkarkimet e të cilës shkojnë fillimisht në gropën septike e më pas në rrjetin e kanalizimeve.

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta, dhe ato urbane

Do të caktohen vende të caktuara në të cilat do të bëhet grumbullimi i mbetjeve të ngurta urbane fillimisht brenda aktivitetit dhe në fund të çdo dite punë këto lloj mbetjesh largohen për në vendin e caktuar për të nga Pushteti Vendor. Kurse pjesa e mbetjeve të cilat dalin nga demontimi i mjeteve në fund të jetës, ato janë vajra lubrifikant të motorrit të cilat grumbullohen në bidona të mbyllur hermetikisht dhe më pas tërhiqen nga subjekti i licensuar me të cilin subjekti ka nënshkruar kontrate, konkretisht këto lloj mbetjesh tërhiqen nga subjekti Amos Oil sh.a.

TAULANT SHPK

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura rrugore është ekzistuese kështu që nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja. Per zhvillimin normal te ketij aktiviteti subjekti ka ber sistemimin e brendshem te sipërfaqes dhe e ka shtruar ate me beton per te mundesuar ne kete menyre dhe levizjen e mjeteve.

- e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit, kohëzgjatja e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;**

Ne aktivitetin pike grumbullimi skrapit dhe demontim makinash nuk kryhen punime ndertimore pasi subjekti ka operuar edhe me pare per kete aktivitet me te njejten vendodhje. Pra ekzistenca e ketij lloj aktiviteti do te jete per aq kohe sa subjekti do te ket pune dhe do jete nevoja per te patur nje aktivitet te tille, aktiviteti zhvillohet ne prone private. Ne rast se mbyllja e aktivitetit do te jete vertet e nevojshme ateher do te behet largimi i te gjithë mbetjeve dhe lendes se pare qe do te jete e pranishme ne momentin e mbylljes dhe do te behet rehabilitimi i vendit duke ber te mundur perdorimin e ambjenteve per dicka tjeter.

Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen dhe sistemimin e terrenit të ndikuar si dhe çdo ndërhyrje tjeter në mënyrë të vazhdueshme që garanton shendetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin e rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngusht me respektimin e kushteve teknike të aktivitetit.

- ë) Lëndët e para që do të përdorën për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);**

Lendet e para qe do te perdoren per piken e grumbullimit te skrapit do te jene kryesisht herurishte te ndryshme si: pajisje elektroshtepiake, makina te aksidentuara, mbetje metalike dhe gjithcka tjeter ne sherbim te punes qe nevojitet per magazinimin e skrapit. Materialet ndihmese te tjera sigurohen ne rruge tregtare te leverdiseshme.

TAULANT SHPK

Lende te para ndihmese jane nafte dhe vajra lubrifikante per makinerite qe do te transportojne lenden e pare. Kamiona vetshkarkues dhe vinca per transportin dhe shkarkimin e lendes se pare. Energji elektrike nga rrjeti per ndricim dhe sipas rastit dhe nevojës qe do te kete ne aktivitet edhe per sherbime te tjera. Uje per nyjet higjeno-sanitare furnizimi me uje behet nga ujesiellesi i zones komform kontrave perkatese.

f) Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

Ushtrimi i ketij aktiviteti do te sjelli bashkpunimin e punes se subjektit me subjekte te tjera ose dhe individe per lenden e pare, studion Mjedisore per pergatitjen e dokumentave per paisjen me lejet respektive, institucionet pergjegjese te OSHEE, Ujesjelles-Kanalizimeve per te ber te mundur lidhjen e energjise elektrike, ujit, si dhe lidhjen per shkarkimin e ujerave te ndotur.

g) Informacionin për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Perzgjedhja e vendodhjes se projektit ne fjale ka ardhur si pasoje e vendodhjes/prones ku do te ushtrohet aktiviteti ne pronesi te administratorit te subjektit AUTO-FAMILJA dhe duke qene se infrastruktura eshte e ngritur, gjithashtu dhe duke qene se aktiviteti eshte zhvilluar dhe me pare ne kete adrese.

gj) Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Gjate funksionimit te aktivitetit pike grumbullimi skrapit dhe demontim makinash lendet e para te cilat do te perdoren jane pajisje elektroshtepiake, makina te aksidentuara, mbetje metalike, gomat e makinave dhe gjithcka tjeter ne sherbim te punes qe nevojitet per magazinimin e skrapit dhe lendet ndihmese do te jene uji, energji elektrike, lende djegese dhe produkte te konsumit te perditshem.

Energjia elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues i zones me te cilin subjekti "AUTO-FAMILJA" ka lidhur nje kontrate te rregullt me OSHEE, dhe per furnizimin me uje ka nje kontrate me Ujesilles Kanalizimet e zones komform kushteve, rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

- h) **Aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.**

Gjate ushtrimit të këtij aktiviteti nuk nevojiten ndertime për kampe apo rezidenca për punetoret pasi nuk do të jete nevojta sepse punetoret do të merren nga zonat në afërsi të vendit ku do të ushtrohet aktiviteti. Përveç projektit në fjalë, nuk ka asnjë produkt tjetër ndertimor ose infrastrukturor që zhvillohet në këto zone dhe që mund të kondiciononte në ecurinë dhe kohezgjatjen e aktivitetit.

- i) **Informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.**

Në bazë të Vendimit Nr.686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjithshme e të afatave për zhvillimin e procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNMP) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklarates mjedisore" subjekti "AUTO-FAMILJA" ka përgatitur dokumentat për tu pajisur me VENDIM mjedisor (VNM Paraprake) si në rastin tjetër. Dhe pas kësaj do të ndjek procedurat për tu pajisur me leje Mjedisore Tipi B sipas ligjit në fuqi.

- j) **Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licensave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar.**

Subjekti në këto faza që ndodhet nuk disponon leje, autorizime dhe licenca, ai është duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për tu pajisur me Vendim Paraprak dhe më pas për Leje Mjedisore Tipi B.

***Hartoi Raportin Teknik:
Për TAULANT SHPK:
Ing.Erjona Qatipi***